



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1711/3 prot.

Tiranë, më 23.12.2019

**VENDIM**  
**Nr.195, datë 23.12.2019**

**“PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 159, DATË 10.12.2019, TË**  
**KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**KONSTATOVA SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “*Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018*”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin e Gjykatës Kushtetuese.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion, i cili është përcjellë nëpërmjet shkresës nr. 260/1 prot., datë 09.09.2019, duke evidentuar punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Institucioni i Gjykatës Kushtetuese ka informuar Komisionerin se, megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë, vazhdojnë ende të jenë në marrëdhënie me shërbimin civil nëpunësit:

- \*\*\*\*\*, me detyrë “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Financës ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 14.08.2019.

- \*\*\*\*\* , me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 24.10.2019.

Në vijim, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri me Vendimin Paralajmërues nr. 159, datë 10.12.2019, ka vendosur:

*“1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e Gjykatës Kushtetuese marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësit e mëposhtëm:*

- \*\*\*\*\* , “Përgjegjëse”, në Sektorin e Financës ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 14.08.2019.
- \*\*\*\*\* , “Drejtor”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 24.10.2019.

*2. Pozicionet respektive të punës, të shpallen menjëherë pozicione të lira dhe të fillojnë procedurat për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.*

*3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda 7 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim.*

...”

Në vijim të zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues nr. 159, datë 10.12.2019, “Mbi paralajmërimin e institucionit Gjykata Kushtetuese, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, institucioni i Gjykatës Kushtetuese përmes shkresës së dërguar me nr. 413/1 prot., datë 23.12.2019, me objekt: “Dërgohet informacion”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1711/2 prot., datë 23.12.2019, ka informuar këtë të fundit, në lidhje me masat e marra nga institucioni në kuadër të realizimit të detyrave të lëna në vendimin paralajmërues nr. 159, datë 10.12.2019, të Komisionerit, si më poshtë vijon:

Për pozicionin e punës “Përgjegjës/e (Shef/e) i/e Sektorit të Financës”, në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore, Gjykata Kushtetuese ka shpallur procedurat për rekrutim, sipas kërkesave të ligjit për shërbimin civil, në datë 31.10.2019. Kjo procedurë ka përfunduar dhe pritet të shpallet publikimi i fituesit në portalin e SHKP-së, si dhe në faqen zyrtare të institucionit më datë 24.12.2019, në respektim të afateve ligjore të parashikuara.

Sa i takon punonjëses \*\*\*\*\* , aktualisht me detyrë “Përgjegjëse”, në Sektorin e Financës, do ti përfundojnë marrëdhëniet e punës në shërbimin civil, në datë 31.12.2019.

Për punonjës in \*\*\*\*\* , me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore, për të cilin Komisioneri ka kërkuar ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të plotësimit të moshës për daljen në pension të plotë pleqërie, institucioni i Gjykatës Kushtetuese ka argumentuar se, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së këtij punonjësi në shërbimin civil do të dëmtonte interesat e punës, pasi funksioni që mbart, mbulon sektorin e financave dhe njësinë përgjegjëse, si dhe autoritetin përgjegjës, që në periudhën kohore në të cilën ndodhemi, faza e mbylljes së buxhetit të vitit 2019 dhe detajimi i buxhetit për vitin 2020, do të pengonte punën në institucion. Nga ana tjetër, duke qenë njësi përgjegjëse, punonjësi ka detyrë funksionale kryerjen e procedurave për plotësimin e vëndeve të lira të punës në shërbimin civil, në institucionin e Gjykatës Kushtetuese, si rrjedhim, kërkohet shtyrja e afatit për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë punonjës.

Në analizë të sa më lart përmendur vërej se:

Në kushtet kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për punonjës in Kujtim Sheshi, do të sillte për institucionin e Gjykatës Kushtetuese, pengesa në ecurinë normale të punës së këtij institucioni, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 159, datë 10.12.2019, “Mbi paralajmërimin e institucionit Gjykata Kushtetuese, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit, nga ana e institucionit të Gjykatës Kushtetuese është e ligjshme.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kreu IV “Rishikimi”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 159, datë 10.12.2019, me përmbajtje si më poshtë:

Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për punonjës in:

- \*\*\*\*\* , me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore,

deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2020.

2. Për këtë vendim të njoftohet Gjykata Kushtetuese dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**